



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 107, datë 22.04.2021

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 242, DATË 21.12.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC ZALL XHUXHË” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 92, pikat 1 dhe 2, si dhe nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 15, të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 56/2 Prot., datë 19.04.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, ka vendosur të licencojë shoqërinë “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:
 - i. Vërtetimin për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.
 - ii. Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, etj).
 - iii. Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për tu tregtuar në GWh, për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
 - iv. Kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë me shkresën e ERE-s nr. 1165/3 prot., datë 24.12.2020, tërhequr dorazi nga përfaqësuesi i shoqërisë në datën 27.12.2020.

- Duke qenë se në përmbushje të afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 242/2020, shoqëria nuk kishte depozituar në ERE dokumentacionin përkatës, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 451 prot., datë 16.03.2021, duke i rikujtuar detyrimin për plotësimin e kushteve të mësipërme.
- Në përgjigje, me shkresën nr. 7 prot., datë 12.04.2021, protokolluar në ERE me nr. 451/1 prot., datë 12.04.2021, shoqëria ka depozituar në ERE Vërtetimin për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore. Me depozitim të këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, germa i, të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242/2020, ndaj ky kusht shqufizohet, bazuar në përcaktimet e nenit 113 të KPA.
- Po ashtu, shoqëria ka depozituar shkresën e protokolluar në ERE me nr. 451/2 prot., me anë të së cilës ka deklaruar se dokumentacioni është dërguar me vonesë nga ana e saj për shkak të infektimit të stafit administrativ të shoqërisë me COVID-19, çka ka sjellë pamundësinë e shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit, si dhe ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të shtyrë me 30 ditë afatin e plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar në kushtet e vendimit nr. 242/2020, që lidhen me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Duke marrë në konsideratë vullnetin e shoqërisë për të plotësuar një pjesë të dokumentacionit, për të përmbushur kushtet përkatëse të vendosura në vendimin e licencimit, vlerësohet se duhet marrë parasysh kërkesa e saj për të shtyrë afatin për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 242/2020. Duke qenë se nga data 27.03.2021, si afati i fundit për të depozituar dokumentacionin përkatës nga shoqëria, ka kaluar pothuajse një muaj, vlerësohet që afati për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 242/2020 të zgjatet me 60 ditë, duke filluar ky afat nga data 28.03.2021, duke përfshirë në këtë mënyrë dhe afatin e kaluar tashmë dhe për t'i dhënë mundësinë shoqërisë që të plotësojë kushtet e vendimit 242/2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Në vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, pika 1;

Ishte:

1. *Të licencojë shoqërinë “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:*
 - i. *Vërtetimin për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.*
 - ii. *Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj).*

- iii. Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për tu tregtuar në GWh për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.*
- iv. Kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.*

Bëhet:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 60 ditëve, duke filluar ky afat nga data 28.03.2021:
 - i. Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim ivetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj).*
 - ii. Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për tu tregtuar në GWh / për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.*
 - iii. Kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimene Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI